# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-466761**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rikthimi i Turqisë në programin F-35/ Erdogan: Trump është pozitiv për këtë perspektivë |
| ADRESA | `https://www.cna.al/kosova-bota/rikthimi-i-turqise-ne-programin-f-35-erdogan-trump-eshte-pozitiv-per-i475126` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 17:08:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 17:03:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e25c6458a8d64bb52ed6f04a4c2f652855de3371e0f163e1433086ac32f11c95` |
| TEKSTI | `73739aa64b18ec6464d08a416ba87a2dc26216f05f3b5f607cbd3180c55d1072` |
| PAMJA | `012bbe9a2e853ca8354d3df24f9a90d44f9cb6d605cd8ce57f49c9660e634ea3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a27f3e6fb4c8687d46cfd94015c3a05e81e1a03fbb062f96fa4481aaaa2cb0a4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e5d36276bdac6f0efd80a0011f78966ff078cd5aec9cbe323cc4b585e15f691e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a27f3e6fb4c8687d46cfd94015c3a05e81e1a03fbb062f96fa4481aaaa2cb0a4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

### E fundit!

x

19:03 Kosova & Bota

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka deklaruar s...

# Rikthimi i Turqisë në programin F-35/ Erdogan: Trump është pozitiv për këtë perspektivë

24 Shtator 2026, 19:03, Kosova & Bota CNA




Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka deklaruar se beson se Turqia do të rikthehet në programin amerikan të avionëve luftarakë F-35, duke theksuar se Ankaraja tashmë pret "hapa konkretë" nga Uashingtoni.

Duke folur për gazetarët gjatë kthimit nga Nju Jorku, ku mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Erdogan tha se presidenti amerikan Donald Trump kishte shprehur një qëndrim pozitiv lidhur me rikthimin e Turqisë në programin F-35.

> *"Presidenti Trump shprehu vullnet pozitiv lidhur me rikthimin e Turqisë në programin F-35"*, deklaroi Erdogan, sipas mediave turke.

Presidenti turk shtoi se Ankaraja pret tashmë hapa konkretë nga pala amerikane, të cilët do të mundësonin rifillimin e bashkëpunimit në fushën e avionëve luftarakë të avancuar.

Turqia u përjashtua nga programi F-35 në vitin 2019, pasi vendosi të blejë sistemin rus të mbrojtjes ajrore S-400. Vendimi shkaktoi reagime të forta nga Shtetet e Bashkuara, të cilat e konsideruan përdorimin e S-400 të papajtueshëm me pjesëmarrjen e Turqisë në programin F-35.

Çështja e F-35 mbetet një nga temat kryesore në marrëdhëniet mes Ankarasë dhe Uashingtonit. Turqia synon të forcojë kapacitetet e saj ajrore përmes avionëve luftarakë të gjeneratës së pestë.

Deklaratat e Erdo?an vijnë pas takimit të tij me Donald Trump në Nju Jork, në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Sipas palës turke, gjatë takimit u diskutuan marrëdhëniet dypalëshe, bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe çështjet e sigurisë rajonale.

Tashmë pritet të shihet nëse "vullneti pozitiv" i përmendur nga Erdogan do të pasohet nga vendime zyrtare të administratës amerikane për rikthimin e Turqisë në programin F-35.
**/CNA**








## Të sugjeruara

### Takim Trump-Putin në dhjetor?/ Reagon Kremlini, ja çfarë mund të ndodhë

**Pas bisedimeve me SHBA-në/ Lukashenko liron 15 të burgosur politikë**

**Çfarë strategjie mund të ndjekë Qeveria e Kosovës për apelin në Hagë?**

**Inteligjenca Artificiale në fokus/ Çfarë deklaruan Trump dhe Xi Jinping në Shtëpinë e Bardhë**

**Gjermania dyfishon parashikimin e rritjes ekonomike për vitin 2026**

**Raporti/ Evropa humbet 120 miliardë euro investime në vit**

**Trump pret në Shtëpinë e Bardhë presidentin e Kinës, Xi Jinping**

**SHBA paralajmëron sulme ruse me dronë në 3 shtete të Europës**

**BE: Keqardhje që Serbia nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për sulmin në Banjskë**

**Mercedes paralajmëron mbylljen e dy fabrikave në Gjermani**

**Zelensky në Asamblenë e OKB-së: Sa më shumë liri veprimi të ketë Putin, aq më i rrezikshëm bëhet**

**"Nuk takohemi me Haxhiun, pa vendosur Kuvendi për 'Specialen'"/ Letra e familjeve Thaçi, Veseli dhe Krasniqi**

**"Do të ketë surpriza"/ Paralajmërimi i Netanyahut para fjalimit në Asamblenë e OKB-së**

**Mbyllet Koloseu në Romë/ Shkak bëhet vdekja e një punëtori**

**Presidenti i Iranit merr fjalën në OKB/ Delegati amerikan braktis sallën**

**Helikopteri ushtarak rus hyn në hapësirën ajrore të Polonisë/ Ngrihen në ajër avionët luftarakë polakë**

**Analiza/ Ja cilët udhëheqës mungojnë në Asamblenë e OKB-së dhe pse**

**Pasojat e rezultateve nga zgjedhjet/ Merz anulon vizitën në OKB, mbledh CDU-në**

**"Kuvendi të zgjedhë nënkryetarin e dytë"/ GJK: Qeveria e Kosovës është zgjedhur në mënyrë kushtetuese**

**Edhe pse shumë herët, gara presidenciale e vitit 2028 në SHBA ka nisur/ Emrat e mundshëm të kandidatëve**

## editorial

10:40 Editorial

**Fshati digjet, këta krihen**

**CNA LIVESTREAM**



Na ndiqni edhe në

## acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

**Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH**

## opinion

14:39 Opinione Ylli Dylgjeri

**VLORË MOJ NUR I PUSHTETIT**

12:05 Opinione Luan Rama

**Skandal pas skandali/ Një palo shtet anëtar i NATO-s**

20:06 Opinione Grigels Muçollari

**Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!**

## **Lifestyle**

19:00 Lifestyle

**Llumi i kafesë me uthull, ja truku praktik për pastrimin e kuzhinës**

Një truk praktik dhe ekonomik pastrimi përfshin përdorimin...

17:52 Lifestyle

**Zbulohen 25 destinacionet më të mira për vitin 2027**

Sapo kemi hyrë në vjeshtë dhe Lonely Planet është tashmë t...

14:00 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.